



**UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA"**  
"Zija Shemsiu" pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës  
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

**FORMULARI I VLERËSIMIT F2**  
(E plotëson Komisioni Vlerësues)

<b>Fakulteti</b>	Fakulteti i Edukimit
Lënda/ët për të cilat është shpallur konkursi	<i>Didaktikë e njohurive gjeometrike (Fillor), Matematika I (Fillor), Matematika II (Fillor), Teknologjia informative (Parashkollor), Etika e mësimdhënies (Fillor), Arsimi gjatë gjithë jetës (Fillor), Kurrikula e matematikës (Mësimdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor, master), Mësimdhënie përmes STEM (Mësimdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor, master).</i>
Thirrja për të cilën konkurren kandidati	Profesor asistent (prof. ass.)
Kandidatët e paraqitur:	1. Habib Rexhepi 2. Besim Berisha

**Sqarim nga Komisioni vlerësues:**

Komisioni vlerësues është bazuar në konkursin për zgjedhjen/rizgjedhjen e personelit të rregullt akademik në njësitë akademike të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan, Ref. nr. 01/595 Dt. 27/02/2025, ku në pikën 3. të konkursit nga Fakulteti i Edukimit (Emërim për herë të parë në thirrjen përkatëse) kërkohet një (1) mësimdhënës për lëndët: *Didaktikë e njohurive gjeometrike (Fillor), Matematika I (Fillor), Matematika II (Fillor), Teknologjia informative (Parashkollor), Etika e mësimdhënies (Fillor), Arsimi gjatë gjithë jetës (Fillor), Kurrikula e matematikës (Mësimdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor, master), Mësimdhënie përmes STEM (Mësimdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor, master).*

Komisionit i kanë arritur dy aplikacione, brenda afatit të përcaktuar kohor, sipas konkursit, të cilët i plotësojnë kushtet formalo-juridike të konkursit.

Komisioni, ka shqyrtuar të gjithë dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët. Komisioni vlerësues dhe në bazë të nenit 15, paragrafi 4, pika 4.1, të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024, kandidatët i ka ftuar për intervistim dhe për një ligjëratë provuese, të cilat janë mbajtur më 20 mars 2025.

Prandaj, Komisioni vlerësues, duke u bazuar në Rregulloren për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024, vlerësimin e tij e paraqet në këtë formular.

**Komisioni vlerësues:**

1. Prof. Dr. Abdullah Zejnullahu, kryetar
2. Prof. Asoc. Dr. Musa Ajeti, anëtar
3. Prof. Ass. Dr. Mensur Neziri, anëtar

## I. TË DHËNAT PËR KANDIDATIN

### Kandidati 1. Emri dhe mbiemri HABIB REXHEPI

**Tabela 1. Të dhënat për kandidatin për të cilin shkruhet raporti**

Emri dhe mbiemri	Habib Rexhepi
Ditëlindja dhe vendlindja	7 tetor 1971, Viti
Grada shkencore dhe viti kur është fituar	Doktor i shkencave në arsimimin e mësimdhënësve (për arsimin fillor), 2024
Titulli akademik (nëse është rizgjedhje)	
Viti kur është fituar titulli aktual (nëse është rizgjedhje)	
Universiteti/fakulteti/departamenti ku është fituar titulli akademik	
Arsimimi i lartë	
STUDIMET THEMELORE	
Institucioni	Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti i Edukimit
Vendi	Prishtinë
Titulli i fituar	Bachelor Matematikë-Informatikë
Data / viti i diplomimit	4.3.2014
Fusha e studimit	Matematikë – Informatikë
STUDIMET MASTER / MAGJISTRATURË	
Institucioni	Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"
Vendi	Prishtinë
Titulli i fituar	Master i Edukimit - Mësimdhënie dhe Kurrikulë
Data / viti i diplomimit	6.3.2017
Fusha e studimit	Mësimdhënie dhe Kurrikulë Tema: "Trajtimi i thyesave në klasën e gjashtë në disa vendet të Ballkanit"
STUDIMET E DOKTORATËS	
Institucioni	Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi", Fakulteti Pedagogjik "Shën Klimenti i Ohrit",
Vendi	Shkup (Maqedoni e Veriut)
Titulli i fituar	Doktor i shkencave në arsimimin e mësimdhënësve (për arsimin fillor) Programi: <i>Arsimimi i mësimdhënësve (për arsimin fillor)</i> Nënprogrami: <i>Arsimimi i mësimdhënësve (për arsimin fillor) në fushën e shkencave matematiko-natyrore,</i> Fusha e ngushtë: <i>Hulumtimi në matematikë</i>

**Tabela 2. Të dhënat lidhur me gradën e fituar shkencore**

Grada shkencore	Doktor i shkencave në arsimimin e mësimdhënësve (për arsimin fillor)
Thirrja e fituar akademike	
Viti kur është fituar thirrja aktuale (vlen për rizgjedhje)	
Vendimi nr.	
Universiteti / Fakulteti / Departamenti	
Nostrifikimi / MASHT/ NARIC	Ref. Nr. 11/3-352, datë: 05.02.2025. MASHT, Prishtinë

**Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 2**

Në bazë të verifikimit të dokumentacionit përkatës vërtetohet se kandidati Habib Rexhepi, i plotëson kushtet formalo-juridike, sipas nenit 172, pika 1, nënpikat 1.1 të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan dhe nenit 7, pika 1, nënpika 1.1, të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, rrimërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024. Kandidati Habib Rexhepi është *Doktor i shkencave në arsimimin e mësimdhënësve (për arsimin fillor)*, në programin *Arsimimi i mësimdhënësve (për arsimin fillor) në fushën e shkencave matematiko-natyrore*, me fushës e ngushtë *Hulumtimi në matematikë*.

**1. Përmbledhje e aktivitetit shkencor të kandidatit**

**Tabela 3. Monografitë**

Nr.	Autori/ët	Titulli i publikimit	Fusha studimore	Recensentët	Shtëpia botuese, vendi, viti
1.	Habib Rexhepi	Thyesat (studim krahasimtar i trajtimit të thyesave ne programet dhe tekstet mësimore të matematikës së klasës VI në disa vende të Ballkanit)	Matematikë	Abdullah Zejnullahu Naim Demiri	"Embeta", Prishtinë, 2025 ISBN: 978-9951-424-92-9
2.	Habib Rexhepi	Koncepti i thyesave sipas teorisë Pirie-Kieren në arsimin fillor matematik	Matematikë	Disertacioni i doktoratës	2024

**Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 3**

Kandidati Habib Rexhepi ka paraqitur monografinë *"Thyesat (studim krahasimtar i trajtimit të thyesave ne programet dhe tekstet mësimore të matematikës së klasës VI në disa vende të Ballkanit)"*, ndërkaq disertacioni i doktoratës me titull *"Koncepti i thyesave sipas teorisë Pirie-Kieren në arsimin fillor matematik"*, i pranohet si monografi. Kandidati Habib Rexhepi, në librin e tij monografik trajton një nga konceptet themelore të matematikës - konceptin e thyesave dhe trajtimin e tyre. Tema është e një rëndësie të veçantë, pasi thyesat, të kuptuarit e tyre paraqesin njërin nga problemet kyçe në edukimin matematikor dhe shpesh paraqesin vështirësi për

nxënësit. Hulumtimi shtrihet në katër vende ballkanike: Kosovë, Shqipëri, Maqedoni të Veriut dhe Mal të Zi duke krijuar një pasqyrë krahasuese mbi trajtimin e thyesave në sistemet arsimore të këtyre vendeve. Monografia ka një strukturë të qartë dhe logjike, duke filluar me një përmbledhje të temës, duke vijuar me bazat teorike të mësimin të thyesave, analizën e dokumenteve arsimore dhe krahasimin mes vendeve të Ballkanit.

Prandaj kandidati Habib Rexhepi i plotëson në tërësi kushtet formalo-juridike, sipas nenit 172, pika 1, nën-pika 1.2 të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan dhe nenit 7, pika 1, nën-pikat 1.2, të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024.

Me këtë rast duhet theksuar se kandidati Habib Rexhepi ka përparësi ndaj kandidatit tjetër, sepse pos disertacionit të doktoratës, e cila i pranohet si monografi, ka të botuar edhe një monografi.

**Tabela 4. Tekstet mësimore**

Nr.	Autori/ët	Titulli i publikimit	Fusha studimore	Recensentët	Shtëpia botuese, vendi, viti
1.					

**Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 4**

//

**Tabela 5. Punimet e publikuara në revistat ndërkombëtare shkencore, sipas UA – MASHT nr. 01/2018 dhe nenit 5, pika 2.5 dhe nenit 10, pika 4 të Rregullores, 01/1328 dt. 26/06/2024, për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ.**

Nr.	Autori/ët	Titulli i punimit	Revista	Vëllimi, nr., faqet, viti	Linku identifikues
1.	Habib Rexhepi, Vesna Makasevska	The Impact of the Pirie-Kieren Theory on Developing Fraction Understanding in Third-Grade Students	Journal of Curriculum Studies Research JCSR. DOI 10.46303/jcsr.2024.18	Vëllimi 6, Nr. 2, faqe196-214, 2024	<a href="https://curriculumstudies.org/index.php/CS/article/view/395/113">https://curriculumstudies.org/index.php/CS/article/view/395/113</a> <a href="https://www.scopus.com/sourceid/21101155951">https://www.scopus.com/sourceid/21101155951</a> Punimi është i indeksuar në <b>SCOPUS</b>
2.	Valbona Berisha, Mjellma Rexhepi, Habib Rexhepi, Ben Klinaku	An investigation of the students' viewpoint on factors affecting achievement in mathematics	Pegem Journal of Education and Instruction. Doi: 10.47750/pegog.14.02.35.	Vëllimi 14, Nr. 2, faqe 309-315, 2024	<a href="https://www.pegegog.net/index.php/pegegog/article/view/2605/799">https://www.pegegog.net/index.php/pegegog/article/view/2605/799</a> Punimi është i indeksuar në <b>Web of Science</b>
3.	Habib Rexhepi, Valbona Berisha	The Characteristics of Tasks Which Present the	Revista EducaOnline.	Vëllimi 16, Nr. 2, faqe 1-14, 2022	<a href="https://revistaeducaonline.eba.ufri.br/edi%C3%A7%C3%B5es-antiores/2022-2/the-">https://revistaeducaonline.eba.ufri.br/edi%C3%A7%C3%B5es-antiores/2022-2/the-</a>

	Concept of Fraction in Mathematics Textbooks for Lower Secondary School in Kosovo		<a href="#">characteristics-of-tasks-which-present-the-concept-of-fraction-in-mathe</a> Punimi është i indeksuar në <b>Web of Science</b>
--	---	--	--

#### Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 5

Kandidati Habib Rexhepi ka botuar 3 punime shkencore në revista të cilat janë të indeksuara në platformat e kërkuara nga MASHTI (Udhëzimi administrativ MASHT 01/2018). Përmes linqeve është verifikuar prania e revistave në platformat e paraqitura në tabelë.

Kështu, tri punimet e kandidatit Habib Rexhepi janë të indeksuara në platformat **Scopus** dhe **Web of Science**. Punimi *“The Impact of the Pirie-Kieren Theory on Developing Fraction Understanding in Third-Grade Students”*, i cili është i indeksuar në platformën Scopus, është në përputhje të plotë me kushtet e konkursit, përkatësisht me lëndët e paraqitura në konkurs. Po kështu edhe dy punimet e tjera siç është punimi *“An investigation of the students’ viewpoint on factors affecting achievement in mathematics”*, sikurse edhe punimi *“The Characteristics of Tasks Which Present the Concept of Fraction in Mathematics Textbooks for Lower Secondary School in Kosovo”*, punime këto të indeksuara në platformën Web of Science kanë të bëjnë me mësimdhënien e matematikës. Të tri këto punime paraqesin arritje të shkëlqyera në fushën e mësimdhënies së matematikës, përkatësisht humlumlumtimin në matematikë.

Në këtë mënyrë kandidati Habib Rexhepi i plotëson kushtet formalo-juridike, sipas nenit 172, paragrafi 1, pika 1.3 të Statutit të Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjilan dhe të nenit 7, paragrafi 1, pika 1.3 të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024. Komisioni vlerësues pasi i verifikoi punimet e tij, duke i marrë për bazë edhe dëshmitë (kopjet) konsideron se kandidati Habib Rexhepi me tri punimet e tij të indeksuara në platformat e kërkuara i përmbush kriteret edhe sipas kërkesave të Agjencisë së Akreditimit të Kosovës, Vendimi nr. 3236/211), datë: 21.09.2021, për përditësimin e Manualit të akreditimit dhe Udhëzimit Administrativ nga MASHT 01/2018. Komisioni vlerësues gjithashtu konsideron se kandidati Habib Rexhepi ka përparësi ndaj kundërkandidatit të tij

**Tabela 6. Punimet e publikuara në revista rajonale (Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, BeH)**

Nr.	Autori/ët	Titulli i punimit	Revista	Vëllimi, nr., faqet, viti	Linku identifikues
1.	Habib Rexhepi	Тестовите на знаења и математичката писменост (Testet e njohurive dhe shkrim leximi matematik)	Педагошка Ревизија (Revista Pedagogjike) Botim i Fakultetit Pedagogjik të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi”, Shkup. UDK 37. ISSN print : 1857-7105, ISSN online: 2545-4307	Nr. 1, 2021. F. 41-48	<a href="https://pfsko.ukim.edu.mk">https://pfsko.ukim.edu.mk</a>

#### Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 6

Kandidati Habib Rexhepi në këtë pjesë ka paraqitur një punim nga fusha e studimit dhe humlumlumtimin në matematikë. Botimi i këtij punimi është i dëshmuar me kopje në aplikacionin e kandidatit.

**Tabela 7. Punimet e publikuara në revista kosovare**

Nr.	Autori/ët	Titulli i punimit	Revista	Vëllimi, nr., faqet, viti	Linku
1.	Habib Rexhepi	Problemet dhe keqkuptimet gjatë të mësuarit të thyesave	Regional Journal of Social Science "Reforma" ISSN: 1800-9797, KDU: 33/34 (05)	Nr. 6, faqe. 419-425, 2018	
2.	Habib Rexhepi	Shkrim leximi matematik në PISA 2021	Revista e Matematikës "Pitagora", Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan	Nr. 1, faqe. 34-35, 2021	

**Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 7**

Kandidati Habib Rexhepi në këtë pjesë ka paraqitur dy punime nga fusha e matematikës, përkatësisht didaktikës së matematikës. Botimi i këtyre punimeve është i dëshmuar me kopje në aplikacionin e kandidatit.

**Tabela 8. Prezantimet në konferenca**

Nr	Autori/ët	Titulli i punimit	Konferenca, simpoziumi etj.	Vëllimi, nr., faqet, viti	Linku
1.	Habib Rexhepi	Fraction in mathematics curriculum in Macedonia and Kosovo	14th International Balkan Congress for Education and Science, "QUALITY IN CONTEMPORARY EDUCATIONAL PROCESSES" Concepts, Strategies, Implementation, Evaluation.	5 - 7 Tetor 2019, Ohër, Maqedonia e Veriut.f.235 -240	<a href="https://www.researchgate.net/profile/Biljana-Cvetkova-Dimov/publication/342047703_FORMING_AND_DEVELOPMENT_OF_AESTHETIC_CATEGORIES_FOR_FINE_ART_WORKS_IN_EARLY_CHILD_DEVELOPMENT/links/5edf912b45851516e661f5d0/FORMING-AND-">https://www.researchgate.net/profile/Biljana-Cvetkova-Dimov/publication/342047703_FORMING_AND_DEVELOPMENT_OF_AESTHETIC_CATEGORIES_FOR_FINE_ART_WORKS_IN_EARLY_CHILD_DEVELOPMENT/links/5edf912b45851516e661f5d0/FORMING-AND-</a>

					<u>DEVELOPMENTS-OF-AESTHETIC-CATEGORIES-FOR-FINE-ART-WORKS-IN-EARLY-CHILD-</u>
2.	Habib Rexhepi, Valbona Berisha	Karakteristikat e detyrave të cilat paraqesin konceptin e thyesës në tekstet e matematikës për shkollën e mesme të ulët në Kosovë	"International Conference "Globalisation and Integration in Contemporary Education".	24-25 qershor 2021. Elbasan, Shqipëri, f. 296-300.	
3.	Habib Rexhepi	Mathematics Curriculum	International Interdisciplinary Conference: "Education and Culture in Contemporary Society".	5-6 nëntor 2021. Korçë, Shqipëri	
4.	Habib Rexhepi	Etika në shkencë me theks në matematikë	The International Annual Scientific Conference of the University "Kadri Zeka" <i>Scientific Identity and Creativity in a Changed World.</i>	30-31 maj 2022, UKZ Gjilan, Kosovë	
5.	Habib Rexhepi	Teoria Pirie-Kieren dhe kuptimi i thyesave	UKZ Conference 2023 "Science and Technology in the Promotion of Human Values"	1-2 qershor 2023, UKZ Gjilan, Kosovë	
6.	Habib Rexhepi	Të mësuarit e thyesave sipas teorisë Pirie-Kieren në klasën e 3-të të arsimit fillor	UKZ 3rd Annual Conference 2024 "Trends and challenges in the development of contemporary society"	13-14 qershor 2024, UKZ Gjilan, Kosovë	
7.	Habib Rexhepi		Participant in the seminar "Modernization of teaching, teaching and learning in the light of modern technology and neuroscience"	Prishtinë, qershor 2017	Pjesëmarrës aktiv
8.	Habib Rexhepi		Conference "Academic Freedom and Ethical Principles", organized by the Erasmus + Office in Kosovo and MEST.	Prishtinë, shtator 2018	Pjesëmarrës aktiv
9.	Habib Rexhepi		"Kosovo Learning Summit", organized by the American School of Kosovo.	Prishtinë, 31 mars - 1 prill 2018	Pjesëmarrës aktiv
10.	Habib Rexhepi		Conference "International Conference on Leadership and Management in Schools and	Prishtinë 5 prill 2018	Pjesëmarrës aktiv

			Business", organized by the University of Prishtina and ISSBS, Celje, Slovenia.		
11.	Habib Rexhepi		Pjesëmarrës në konferencën "Konferenca e tretë e Matematikës".	Gjakovë, maj 2017	Pjesëmarrës aktiv
12.	Habib Rexhepi		Pjesëmarrës në edicionine tretë të Konferences trainuese "+Education" të organizuar nga Balkans Youth Public Council Diplomacy.	Prishtinë, nëntor 2019	Pjesëmarrës aktiv
13.	Habib Rexhepi		Pjesëmarrës në tryezën me fakultetet e edukimit në Kosovë. Tematika: "Rëndësia e krijimit të një ekosistemi stimulus për zhvillimin në fëmijërinë e hershme", tema: "Mirëqenia". Projekti Shprese, Caritasi Zvicëran.	Gjilan, qershor 2021	Pjesëmarrës aktiv
14.	Habib Rexhepi		Pjesëmarrës në punëtorinë "Harmonizimi i Syllabuseve te Fakulteteve te Edukimit me Kërrikullin Bërthamë të Kosovës përmes Aktiviteteve Praktike" të organizuar nga projekti Shprese, Caritasi Zvicëran.	Gjilan, prill 2021	Pjesëmarrës aktiv

#### Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 8

Kandidati Habib Rexhepi në këtë pjesë ka paraqitur pjesëmarrjen e tij në 14 konferenca shkencore, tejet të rëndësishme, nga fusha e studimit dhe hulumtimit në matematikë, si dhe nga fusha e metodologjisë së mësimdhënies, qoftë me karakter kombëtar apo ndërkombëtar.

Po kështu vlen të theksohet se kandidati Habib Rexhepi në 6 konferenca është paraqitur me punime, të cilat kanë zgjuar vëmendjen tek auditoriumi. Ndërkaq, në konferencat e tjera ka qenë pjesëmarrës aktiv, duke kontribuar nëpërmjet diskutimeve.

Prandaj, kandidati Habib Rexhepi i plotëson kushtet formalo-juridike, nenit 7, paragrafi 1, pika 1.4 të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024. Kandidati Habib Rexhepi pjesëmarrjen e tij në këto konferenca e ka dëshmuar me certifikatat e afuara.

#### Tabela 9. Kontribute të tjera shkencore dhe profesionale

Nr.	Autorët (renditja si në kontributin shkencor)	Lloji i kontributit shkencor	Vendi, viti
1.	Habib Rexhepi	Koordinator i SHFMU "Bafti Haxhiu" për zbatimin e Kurrikulit të Ri të Kosovës	Viti, 2014
2.	Habib Rexhepi	Trajner i licencuar për zbatimin e Kurrikulës së Re të	Prishtinë, 2017



		Kosovës për fushën e matematikës	
3.	Habib Rexhepi	Koordinator për organizimin e garës ndërkombëtare të matematikës “Kangaroo” për komunën e Vitisë	Instituti “Atomi”, Prishtinë, 2017-2018
4.	Habib Rexhepi	Këshilltar “Akademia Education USA – Këshillim për studime në SHBA dhe bursa”	American Advising Center, Prishtinë, 2017
5.	Habib Rexhepi	Trajner “Përgatitje për Testin Standardizues Ndërkombëtar – SAT Math”	American Advising Center, Prishtinë, 2018

**Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 9**

Kandidati Habib Rexhepi në këtë pjesë ka paraqitur 5 kontribute të tjera shkencore dhe profesionale.

**Tabela 10. Përvoja në mësimdhënie universitare**

Periudha e angazhimit (vitet akademike)	Grada shkencore dhe Thirrja akademike	Institucioni, Vendi	Programi i studimit	Ligjërues i lëndëve	Vërejtje
2017/18 – në vazhdim	Ligjërues dhe asistent i angazhuar	Universiteti “Kadri Zeka”, Fakulteti i Edukimit	Arsimi Fillor Arsimi Parashkollor	Matematikë 1, Matematikë 2, Konceptet themelore matematikore, Konceptet themelore gjeometrike, Lojërat matematikore, Didaktika e mësimdhënies së matematikës, Didaktika e matematikës për fëmijë, Didaktika e mësimdhënies së gjeometrisë për fëmijë, TIK-u në Arsimin Parashkollor	

**Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 10**

Kandidati Habib Rexhepi ka një përvojë të mirë në arsimin e lartë, qoftë në cilësinë e asistentit në lëndët nga fusha e matematikës, qoftë duke qenë bartës i lëndëve po nga fusha e matematikës, që nga viti

akademik 2017-2018, pra i ka vite përvojë pune në arsimin e lartë. Duhet të theksohet se të gjitha këto vite të përvojës i ka realizuar në, UKZ, përkatësisht në Fakultetin e Edukimit (programet e nivelit baçelor Arsimi Fillor dhe Arsimi Parashkollor), me ç'rast sipas Zyrës për Zhvillim Akademik dhe Cilësi ka treguar performancë të shkëlqyer në mësimdhënie.

Duke u bazuar në përvojën e tij në arsimin e lartë, si dhe në performancën e tij të treguar në Fakultetin e Edukimit në UKZ, mund të thuhet se në tërësi i plotëson kushtet për zgjedhjen e tij për herë të parë në thirrjen *profesor asistent (prof. ass.)*.

Kandidati Habib Rexhepi i plotëson kushtet formalo-juridike, sipas nenit 172, paragrafi 1, pika 1.4 dhe pika 1.5, të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan dhe të nenit 7, paragrafi 1, pika 1.5 dhe pika 1.6 të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024.

Komisioni vlerësues konstaton se kandidati Habib Rexhepi të dhënat e afuara në aplikacionin e tij i ka dëshmuar me kopjet e kontratave, si dhe me notimin e studentëve. Po kështu nga përvoja e tij duket qartë ai ka qenë i angazhuar në lëndët të cilat janë përputhje të plotë me lëndët e paraqitura në konkurs. Prandaj i njëjti ka përparësi në krahasim me kundërkandidatin e tij

**Tabela 11. Udhëheqje të temave master dhe të doktoratës**

Periudha e mentorimit	Institucioni, Vendi	Mentorime në studimet Master	Mentorime në studimet e doktoratës	Vërejtje

**Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 11**

//
----

**Tabela 12. Pjesëmarrja e dëshmuar në programe ose projekte të kërkimeve themelore dhe të aplikueshme**

Nr.	Programi/ projekti shkencor	Periudha kohore	Institucioni, vendi	Pozita në program, projekt/ Kontribut
1.	"Mësimdhënia me nxënësin në qendër"	2004	KEDP (Kosovo Education Development Project)	
2.	"Në hap me kohën"	2006	Association EDU-POOL & Shoqata "Pedagogu" Gjilan	
3.	"Metodat kreative si mjet pedagogjik dhe aplikimi i tyre në njësinë mësimore".	2007	World Child Kosova	
4.	Trajnimi për trajner "Për fushën e Matematika në zbatimin e Kurrikulës së Re"	2018	MASHT	
5.	"Zbatimi e Kurrikulës së Re për fushën e matematikës"	2017	Learning Together	
6.	"Mjediset mësimore mike për fëmijë"	2017	Learning Together	

7.	“Akademia Education USA – Këshillim për studime në SHBA dhe bursa”	2018	American Advising Center	
8.	“Përgatitja për Testin Standardizues Ndërkombëtar – SAT Math”	2017	American Advising Center	
9.	Mendimi kritik, zgjidhja e problemeve dhe bazat e mikrobit-it	2019	British Council	
10.	Bazat e Micro:bit-it – Kodimi	2019	British Council	
11.	“Zhvillimi i shkathtësive të mësimdhënies për pilotimin e Kurrikulës së Re”	2014	MASHT, Instituti Pedagogjik i Kosovës	
12.	“Matematika dhe mësimdhënia e matematikës me fokus të veçantë në gjeometri për klasat 6-9”	2016	MASHT, German Cooperation, GIZ	
13.	“Vlerësimi për nxënie”	2014	MASHT, USAID	
14.	Kosovo learning Summit	31.3.-1.4.2018	American School of Kosovo & MASHT	

**Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 14**

Kandidati Habib Rexhepi ka marrë pjesë në një varg aktivitete, qoftë në formë punëtorie, qoftë në formë të trajnimit.

## II. TË DHËNAT PËR KANDIDATIN

### Kandidati 2. Emri dhe mbiemri BESIM BERISHA

**Tabela 1. Të dhënat për kandidatin për të cilin shkruhet raporti**

Emri dhe mbiemri	Besim Berisha
Ditëlindja dhe vendlindja	1 mars 1963, Llabjan, Pejë
Grada shkencore dhe viti kur është fituar	Doktor i shkencave të matematikës në Arsim, 2024
Titulli akademik (nëse është rizgjedhje)	
Viti kur është fituar titulli aktual (nëse është rizgjedhje)	
Universiteti/fakulteti/departamenti ku është fituar titulli akademik	
Arsimimi i lartë	
STUDIMET THEMELORE	
Institucioni	Universiteti i Prishtinës Fakulteti i Edukimit, Qendra në Gjakovë
Vendi	Gjakovë
Titulli i fituar	Bachelor i Matematikë-Informatikës
Data / viti i diplomimit	11 korrik 2014
Fusha e studimit	Matematikë – Informatikë
STUDIMET MASTER / MAGJISTRATURË	
Institucioni	Universiteti i Tetovës, Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore
Vendi	Tetovë, Maqedoni e Veriut
Titulli i fituar	Master i matematikës
Data / viti i diplomimit	18 janar 2017
Fusha e studimit	Analizë komplekse
STUDIMET E DOKTORATËS	
Institucioni	Universiteti i Sarajevës, Fakulteti Shkencave Matematike Natyrore
Vendi	Sarajevë, (Bosnje dhe Hercegovinë)
Titulli i fituar	Doktor i shkencave të matematikës në arsim

**Tabela 2. Të dhënat lidhur me gradën e fituar shkencore**

Grada shkencore	Doktor i shkencave të matematikës në arsim
Thirrja e fituar akademike	
Viti kur është fituar thirrja aktuale (vlen për rizgjedhje)	
Vendimi nr.	
Universiteti / Fakulteti / Departamenti	
Nostrifikimi / MASHT/ NARIC	Ref. Nr. 11/3-846, datë: 05.03.2025. MASHT, Prishtinë

## Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 2

Kandidati Besim Berisha është doktor i shkencave të matematikës në arsim.

Në bazë të verifikimit të dokumentacionit përkatës vërtetohet se kandidati Besim Berisha, i plotëson kushtet formalo-juridike, sipas nenit 172, pika 1, nënpika 1.1 të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan dhe nenit 7, pika 1, nënpikat 1.1, të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024.

## 2. Përmbledhje e aktivitetit shkencor të kandidatit

**Tabela 3. Monografitë**

Nr.	Autori/ët	Titulli i publikimit	Fusha studimore	Recensentët	Shtëpia botuese, vendi, viti
1.	Besim Berisha	Trajektoret e ndërtimit të koncepteve matematikore bazuar në modelin e kompetencave matematikore	Matematikë arsimore	Disertacioni i doktoratës	2024

## Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 3

Kandidati Besim Berisha nuk ka prezantuar monografi të botuar, mirëpo sipas nenit 172, paragraf 1.2 të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan Nr.07-V-096, dt.10.12.2020 dhe neni 7, paragrafi 1.2 i Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan, me numër reference 01/1328, dt.26.06.2024, disertacioni i doktoratës i njihet si monografi.

**Tabela 4. Tekstet mësimore**

Nr.	Autori/ët	Titulli i publikimit	Fusha studimore	Recensentët	Shtëpia botuese, vendi, viti
1.					

## Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 4

//

**Tabela 5. Punimet e publikuara në revistat ndërkombëtare shkencore, sipas UA – MASHT nr. 01/2018 dhe nenit 5, pika 2.5 dhe nenit 10, pika 4 të Rregullores, 01/1328 dt. 26/06/2024, për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ.**

Nr.	Autori/ët	Titulli i punimit	Revista	Vëllimi, nr., faqet, viti	Linku identifikues
1.	Besim Berisha Xhevdet Thaqi Astrit Ramizi	Universal tools for analysing structures and interactions in	Innovaciencia	V. 11. nr. 1	<a href="https://doi.org/10.15649/2346075X.3602">https://doi.org/10.15649/2346075X.3602</a>

	Agon Mahmuti	geometry			<a href="https://www.scopus.com/result/s/authorNamesList.uri?sort=count-f&amp;src=al&amp;sid=bfa8e54a9c8e2ff1c562e21e8aa40d72&amp;sot=al&amp;sdt=al&amp;sl=42&amp;s=AUTHLASTNAME%28Berisha%29+AND+AUTHFIRST%28Besim%29&amp;st1=Berisha&amp;st2=Besim&amp;orcidId=&amp;selectionPageSearch=ani&amp;reselectAuthor=false&amp;activeFlag=true&amp;showDocument=false&amp;resultsPerPage=20&amp;offset=1&amp;jtp=false&amp;currentPage=1&amp;previousSelectionCount=0&amp;tooManySelections=false&amp;previousResultCount=0&amp;authSubject=LFSC&amp;authSubject=HLSC&amp;authSubject=PHSC&amp;authSubject=SOSC&amp;exactAuthorSearch=false&amp;showFullList=false&amp;authorPreferredName=&amp;origin=searchauthorfreelookup&amp;affiliationId=&amp;txGid=6e4f13c7d76b8c7aa189f5ead09c55a4">https://www.scopus.com/result/s/authorNamesList.uri?sort=count-f&amp;src=al&amp;sid=bfa8e54a9c8e2ff1c562e21e8aa40d72&amp;sot=al&amp;sdt=al&amp;sl=42&amp;s=AUTHLASTNAME%28Berisha%29+AND+AUTHFIRST%28Besim%29&amp;st1=Berisha&amp;st2=Besim&amp;orcidId=&amp;selectionPageSearch=ani&amp;reselectAuthor=false&amp;activeFlag=true&amp;showDocument=false&amp;resultsPerPage=20&amp;offset=1&amp;jtp=false&amp;currentPage=1&amp;previousSelectionCount=0&amp;tooManySelections=false&amp;previousResultCount=0&amp;authSubject=LFSC&amp;authSubject=HLSC&amp;authSubject=PHSC&amp;authSubject=SOSC&amp;exactAuthorSearch=false&amp;showFullList=false&amp;authorPreferredName=&amp;origin=searchauthorfreelookup&amp;affiliationId=&amp;txGid=6e4f13c7d76b8c7aa189f5ead09c55a4</a>
2.	Agon Mahmuti Xhevdet Thaqi Fehmi Ramadani Besim Berisha	Mathematical Competences and Geometric Meaning of Algebraic Expressions. Learning trajectories	Revista de Gestão Social e Ambiental	V. 13. nr. 3, 2025	<a href="https://doi.org/10.24857/rgsa.v19n3-012">https://doi.org/10.24857/rgsa.v19n3-012</a>

#### Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 5

Kandidati Besim Berisha ka paraqitur 2 punime të publikuara në revista ndërkombëtare shkencore. Përmes linqeve në tabelë është bërë verifikimi i punimeve të paraqitura. Në këtë mënyrë është verifikuar se punimi "Universal tools for analysing structures and interactions in geometry", i botuar në revistën "Innovaciencia", v. 11, nr. 1, është i indeksuar edhe në platformën SCOPUS. Ndërkaq, punimi "Mathematical Competences and Geometric Meaning of Algebraic Expressions. Learning trajectories", i botuar në revistën "Revista de Gestão Social e Ambiental", V. 13. nr. 3, 2025, nuk është i indeksuar në platformën SCOPUS, sepse revista në fjalë është larguar nga platforma.

Meqenëse kërkohet së paku një punim në platformat sipas Udhëzimit Administrativ – MASHT Nr. 1/2018 dhe sipas nenit 172, paragrafi 1.3 i Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan dhe nenit 7, paragrafi 1.3 dhe nenit 10, paragrafi 4, nën paragrafi 1.2 i Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik, në Universitetin Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan, me numër reference 01/1328, dt.26.06.2024, kandidati në këtë pikë i plotëson kushtet formalo juridike.

Megjithatë duhet theksuar se kandidati Besim Berisha nuk i ka afruar dëshmitë (kopjet) e plota për këto dy punime, sepse në dokumentacionin e tij fizik ka sjell vetëm faqet e para të punimeve, sipas kushteve të konkursit (Ref. nr. 01/595 Dt. 27/02/2025).

**Tabela 6. Punimet e publikuara në revista rajonale (Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, BeH)**

Nr.	Autori/ët	Titulli i punimit	Revista	Vëllimi, nr., faqet, viti	Linku identifikues
1.	Besim Berisha (Ko-autor)	The Construction of Mathematical Concepts According to a Model Based on Mathematical Competencies	EDUCA University of Mostar, <a href="https://nf.unmo.ba/media/pafo0jhw/educa_17_web.pdf">https://nf.unmo.ba/media/pafo0jhw/educa_17_web.pdf</a>	V. XVII, nr. 17, 2024	Copernicus EBSCO
2.	Besim Berisha (korrespondent autor)	Implementations of first-order differential equations	University of Tetovo – FNMS. <a href="https://sites.google.com/unite.edu.mk/inism/vol-7-no-13-14-2022">https://sites.google.com/unite.edu.mk/inism/vol-7-no-13-14-2022</a>	V. 7, nr. 13-14, 2022, Tetovo, N. Macedonia	<a href="https://sites.google.com/unite.edu.mk/inism/vol-7-no-13-14-2022">https://sites.google.com/unite.edu.mk/inism/vol-7-no-13-14-2022</a>

**Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 6**

Kandidati Besim Berisha ka paraqitur 2 punime nga fusha e matematikës, por nuk ka sjellë dëshmi (kopje) për këto punime, sipas kushteve të konkursit (Ref. nr. 01/595 Dt. 27/02/2025).

**Tabela 7. Punimet e publikuara në revista kosovare**

Nr.	Autori/ët	Titulli i punimit	Revista	Vëllimi, nr., faqet, viti	Linku

**Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 7**

Kandidati Besim Berisha nuk ka paraqitur asnjë punim të botuar në revistat kosovare.

**Tabela 8. Prezantimet në konferenca**

Nr.	Autori/ët	Titulli i punimit	Konferenca, simpoziumi etj.	Vëllimi, nr., faqet, viti	Linku
1.	Besim Berisha	Mathematics Education Standards and Competencies	UKZAC 2023, MathDay Conference, Gjilan	MathDay Conference, pp. 48	<a href="https://conferences2023.unite.edu.mk/gjilan.net/book-of-abstract">https://conferences2023.unite.edu.mk/gjilan.net/book-of-abstract</a>
2.	Besim Berisha	The trajectories of the construction of mathematical concepts	3rd Barcelona Conference on Education	BCE2022. Barcelona. IAFOR	
3.	Besim Berisha	The trajectories of the construction of geometric concepts	UKZAC 2022, MathDay Conference, Gjilan	MathDay Conference, pp. 44	<a href="https://conferences2022.unite.edu.mk/gjilan.net/book-of-abstract">https://conferences2022.unite.edu.mk/gjilan.net/book-of-abstract</a>

		the case of the quadrilateral			<a href="http://gjilan.net/book-of-abstract">gjilan.net/book-of-abstract</a>
4.	Besim Berisha	Kompetencat matematikore dhe kuptimi gjeometrik i shprehjeve algjebrike	Ditët e matematikës në Tiranë, 13-14 dhjetor 2024, FSHN	FSHN, Universiteti i Tiranës	<a href="https://fshn.edu.al/departments/departamenti-matematikës">https://fshn.edu.al/departments/departamenti-matematikës</a>

#### Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 8

Kandidati Besim Berisha në këtë pjesë ka paraqitur pjesëmarrjen e tij në 4 konferenca shkencore nga fusha e matematikës. Megjithatë Komisioni vlerësues konstaton se kandidati nuk ka sjellë asnjë dëshmi për pjesëmarrjen e tij në konferenca.

#### Tabela 9. Kontribute të tjera shkencore dhe profesionale

Nr.	Autorët (renditja si në kontributin shkencor)	Lloji i kontributit shkencor	Vendi, viti
1.			

#### Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 9

Kandidati Besim Rexhepi nuk ka paraqitur asnjë kontribut tjetër shkencor apo profesional.

#### Tabela 10. Përvoja në mësimdhënie universitare

Periudha e angazhimit (vitet akademike)	Grada shkencore dhe Thirrja akademike	Institucioni, Vendi	Programi i studimit	Ligjërues i lëndëve	Vërejtje
Viti 2017-2018, semestri dimëror Viti 2018-2019 Viti 2020-2021 semestri dimëror Viti 2021-2022 semestri dimëror Viti 2023-2024 semestri dimëror	Asistent i angazhuar	Universiteti "Haxhi Zeka", Pejë	Fakulteti i Menaxhimit në Turizëm, Hoteleri dhe Mjedis	Matematika për ekonomist, Statistika për biznes	

#### Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 10

Kandidati Besim Berisha në aplikimin e tij i ka ofruar vetëm një vërtetim të përvojës së punës në arsimin e lartë, nga Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë, sipas të cilit ka qenë i angazhuar në semestrat dimërorë, në cilësinë e asistentit, për vetëm dy lëndë, të cilat nuk korrespondojnë me lëndët e paraqitura në konkurs. Po kështu, kandidati ndonëse e ka ofruar një vërtetim të përvojës së punës, megjithatë, komisioni i vlerësimit konstaton se nuk i ka sjellë kontratat e punës.



**Tabela 11. Udhëheqje të temave master dhe të doktoratës**

Periudha e mentorimit	Institucioni, Vendi	Mentorime në studimet Master	Mentorime në studimet e doktoratës	Vërejtje

**Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 11**

//

**Tabela 12. Pjesëmarrja e dëshmuar në programe ose projekte të kërkimeve themelore dhe të aplikueshme**

Nr.	Programi/ projekti shkencor	Periudha kohore	Institucioni, vendi	Pozita në program, projekt/ Kontribut
15.				

**Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 14**

//

### III. PËRFUNDIMI DHE PROPOZIMI

(THIRRJA AKADEMIKE E CILA PROPOZOHET) *Profesor asistent (Prof. ass.)*

Komisioni vlerësues, i formuar me vendimin e Këshillit të Fakultetit të Edukimit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan (Nr. prot. 118, dt. 06.03.2025), duke u bazuar në nenin 172 të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan, Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024. dhe konkursin për zgjedhjen/rizgjedhjen e personelit të rregullt akademik në njësitë akademike të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan, Ref. nr. 01/595 Dt. 27/02/2025, pas shqyrtimit të dosjes së kandidatit dr.sc. Habib Rexhepi, për pozitën një mësimsdhënës për lëndët: *Didaktikë e njohurive gjeometrike* (Fillor), *Matematika I* (Fillor), *Matematika II* (Fillor), *Teknologjia informative* (Parashkollor), *Etika e mësimsdhënies* (Fillor), *Arsimi gjatë gjithë jetës* (Fillor), *Kurrikula e matematikës* (Mësimsdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor, master), *Mësimsdhënie përmes STEM* (Mësimsdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor, master).

### PROPOZON

**Dr. sc. Habib Rexhepi** për thirrjen akademike *Profesor asistent (Prof. Ass.)* në Fakultetin e Edukimit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan.

### ARSYETIM

Komisioni erdhi deri te ky propozim duke pasur për bazë se kandidati Dr. sc. Habib Rexhepi i plotëson të gjitha kushtet e parapara sipas konkursit.

Duke u bazuar në nenin 172 të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan; nenin 7, Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024. dhe konkursin për zgjedhjen/rizgjedhjen e personelit të rregullt akademik në njësitë akademike të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan, Ref. nr. 01/595 Dt. 27/02/2025, si dhe në dokumentacionin e kandidatit, Komisioni vlerësues, njëzëri propozon që kandidati Dr.sc. Habib Rexhepi të zgjedhet në thirrjen **Profesor asistent (Prof. Ass.)** për lëndët: *Didaktikë e njohurive gjeometrike* (Fillor), *Matematika I* (Fillor), *Matematika II* (Fillor), *Teknologjia informative* (Parashkollor), *Etika e mësimsdhënies* (Fillor), *Arsimi gjatë gjithë jetës* (Fillor), *Kurrikula e matematikës* (Mësimsdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor, master), *Mësimsdhënie përmes STEM* (Mësimsdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor, master).

Këtë propozim, komisioni e bazon në këto fakte të detajuara:

- Kandidati Habib Rexhepi është *Doktor i shkencave në arsimimin e mësimsdhënësve (për arsimin fillor)*, në programin Arsimimi i mësimsdhënësve (për arsimin fillor) në fushën e shkencave matematikonoaturore, me fushën e ngushtë *Hulumtimi në matematikë*, me çka i plotëson kushtet formalo-juridike në përputhje me nenin 172, pika 1, nënpika 1.1 të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan dhe nenit 7, pika 1, nënpikat 1.1, të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024.
- Kandidati Habib Rexhepi ka të botuar një monografi nga fusha e mësimsdhënies së matematikës, përderisa edhe doktorata i njihet si monografi, me çka i plotëson kushtet sipas nenit 172, pika 1, nënpika 1.2 të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan dhe nenit 7, pika 1, nënpikat 1.2, të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024.
- Kandidati Habib Rexhepi ka botuar 3 punime shkencore në revista të indeksuar në platformat Scopus dhe Web of Science, platforma këto të kërkuara edhe nga MASHTI (Udhëzimi administrativ MASHT 01/2018). Në këtë mënyrë kandidati i plotëson kushtet formalo-juridike, sipas nenit 172, paragrafi 1, pika 1.3 të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan dhe të nenit 7, paragrafi 1, pika 1.3

të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024. Po kështu kandidati Habib Rexhepi me tri punimet e tij të indeksuara në platformat e kërkuara i përmbush kriteret sipas kërkesave të Agjencisë së Akreditimit të Kosovës, Vendimi nr. 3236/211), datë: 21.09.2021, për përditësimin e Manualit të akreditimit dhe Udhëzimit Administrativ nga MASHT 01/2018.

- Kandidati Habib Rexhepi ka marrë pjesë në disa konferenca shkencore, me çka i plotëson kushtet formalo-juridike, sipas nenit 7, paragrafi 1, pika 1.4 të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024.
- Kandidati Habib Rexhepi ka një përvojë të gjatë në arsimin e lartë, madje pikërisht në UKZ, në Fakultetin e Edukimit ka qenë i angazhuar, qoftë si asistent, qoftë si ligjërues në lëndët nga fusha e matematikës, të cilat janë në përputhje me kërkesat e konkursit, me çka i plotëson kushtet formalo-juridike, sipas nenit 172, paragrafi 1, pika 1.4 dhe pika 1.5, të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan dhe të nenit 7, paragrafi 1, pika 1.5 dhe pika 1.6 të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024. Po kështu, sipas Zyrës për Zhvillim Akademik dhe Cilësi ka treguar performancë të shkëlqyer në mësimdhënie.
- Kandidati Habib Rexhepi ka bërë diferencën gjatë intervistimit dhe ligjëratës provuese, duke treguar performancë të shkëlqyer.

#### NUK PROPOZON

Komisioni vlerësues nuk e propozon kandidatin Dr. Sc. Besim Berisha për titullin *Profesor i Asistent (Prof. Ass.)* në Fakultetin e Edukimit në Universitetin Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, pasi në këtë pozitë është zgjedhur kandidati tjetër, i cili i plotëson në tërësi dhe më së miri kushtet e konkursit, si dhe ka përparësi të konsiderueshme ndaj këtij.

#### ARSYETIM

Komisioni vlerësues ka shikuar në tërësi aplikacionin e kandidatit Dr. sc. Besim Berisha dhe duke u bazuar në nenin 172 të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan; nenin 7, Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024. dhe konkursin për zgjedhjen/rizgjedhjen e personelit të rregullt akademik në njësitë akademike të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan, Ref. nr. 01/595 Dt. 27/02/2025), njëzëri ka marrë vendim që kandidati Besim Berisha të mos propozohet për thirrjen *profesor asistent (prof. ass)*, pasi për këtë pozitë është propozuar kandidati tjetër, i cili i plotëson kushtet më mirë dhe në tërësi.

Prandaj, lidhur me këtë, Komisioni vlerësues konstaton si në vijim:

- Kandidati Besim Berisha është doktor i shkencave të matematikës në arsim, me çka i plotëson kushtet e konkursit, me çka i plotëson kushtet formalo-juridike, sipas nenit 172, pika 1, nënpika 1.1 të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan dhe nenit 7, pika 1, nënpikat 1.1, të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024.
- Kandidati Besim Berisha nuk ka prezantuar monografi të botuar, mirëpo sipas nenit 172, paragraf 1.2 të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan Nr.07-V-096, dt.10.12.2020 dhe neni 7, paragrafi 1.2 i Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, me numër reference 01/1328, dt.26.06.2024, disertacioni i doktoratës i njihet si monografi.

- Kandidati Besim Berisha i ka paraqitur dy (2) punime të publikuara në revista ndërkombëtare shkencore. Përmes linkut në tabelë është bërë verifikimi i punimeve i tyre. Në këtë mënyrë është verifikuar se vetëm njëri prej punimeve të tij është i indeksuar në platformën Scopus. Ndërkaq punimi tjetër, i paraqitur nga kandidati nuk është i indeksuar në Scopus, sepse është botuar në një revistë e cila është larguar nga platforma Scopus. Po kështu kandidati nuk i ka afruar dëshmitë (kopjet) e plota për këto dy punime (në dokumentacionin e tij fizik ka sjell vetëm kopjet e faqeve të para të punimeve), sipas pikës 2, nënpika h, të konkursit (Ref. nr. 01/595 Dt. 27/02/2025), me rastin e aplikimin kërkohej edhe dëshmi (kopjet) për punimet shkencore.
- Kandidati Besim Berisha edhe pse ka paraqitur pjesëmarrjen e tij në 4 konferenca shkencore nga fusha e matematikës, por nuk ka sjellë asnjë dëshmi për pjesëmarrjen e tij në konferenca, ku sipas pikës 2, nënpika h, të konkursit (Ref. nr. 01/595 Dt. 27/02/2025), me rastin e aplikimin kërkohej edhe dëshmi për pjesëmarrje në konferenca.
- Kandidati Besim Berisha në aplikimin e tij i ka ofruar vetëm një vërtetim të përvojës së punës në arsimin e lartë, nga Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë, sipas të cilit ka qenë i angazhuar në semestrat dimërorë, në cilësinë e asistentit, për vetëm dy lëndë, të cilat nuk korrespondojnë me lëndët e paraqitura në konkurs. Po kështu, kandidati ndonëse e ka vërtetimin e përvojës së punës, megjithatë i ka sjellë dëshmitë për përvojën e punës, në këtë rast kontratat e punës, ashtu siç kërkohet sipas pikës 2, nënpika i, të konkursit Ref. nr. 01/595 Dt. 27/02/2025).
- Kandidati Besim Berisha nuk e ka ofruar biografinë (CV) e tij, e cila kërkohet sipas pikës 2, nënpika b, të konkursit (Ref. nr. 01/595 Dt. 27/02/2025).

Nënshkrimet origjinale nga anëtarët e Komisionit vlerësues:

Prof. Dr. Abdullah Zejnullahu, kryetar

Prof. Asoc. Dr. Musa Ajeti, anëtar

Prof. Ass. Dr. Mensur Neziri, anëtar

Gjilan, më 21 mars 2025